



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 19.1.2024

- Lënda:** Parashtrimet e Komisionerit Publik lidhur me *Gjetjen dhe Opinionin e ONM-së*, datë 8.1.2024, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Ylli Bashaj, konfirmuar në detyrë me anë të vendimit nr. 671, datë 14.6.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 65 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në seancën gjyqësore datë 15.1.2024, ora 09:00, të zhvilluar në Kolegj, që i përket çështjes (JR) 33/2023, datë 20.7.2023, mbi ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 671, datë 14.6.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Ylli Bashaj, ndër të tjera, trupi gjykues vendosi të pranojë në cilësinë e *provës Gjetje dhe mendim* të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) depozituar në Kolegj në datën 8.1.2024.

Në këtë seancë, trupi gjykues i kërkoi Komisionerit Publik të *mbajë një qëndrim lidhur me gjetjet e ONM-së, situatën faktike konkrete së cilës i referohen, si dhe adresimin e tyre në shkaqet e ankimit.*

Sa më sipër, Komisioneri Publik, *lidhur me Gjetjet dhe Opinionin e ONM-së*, në referencë të përmbajtjes së këtij dokumenti,¹ në lidhje me shkaqet e ankimit, shprehet se:

1. Lidhur me përmbajtjen e Gjetjes - (A) Mbi parimin e proporcionalitetit dhe lidhjen e tij me analizën financiare

1.1 Vëzhguesi ndërkombëtar, duke referuar dhe jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ka dëshiruar të tërheqë vëmendjen e Kolegjit dhe të nënvizojë praktikatat e ndryshme që tregojnë diferenca negative minimale, që kanë çuar në shkarkimin nga detyra të subjekteve

¹ Vënë në dispozicion të Komisionerit Publik në seancën e datës 10.1.2024, në gjuhën angleze, si dhe i përkthyer në gjuhën shqipe.

të rivlerësimit, bazuar në zbatimin e nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016 (në vendimet e formës së prerë).

1.2 Vëzhguesi Ndërkombëtar, në këtë Gjetje/Opinion, ka përfunduar se *zbatimi i parimit të proporcionalitetit bazohet në faktet dhe veçoritë aktuale të çdo procesi rivlerësimi dhe në interpretimin e historikut financiar të secilit subjekt rivlerësimi dhe personave të lidhur me të (ose persona të tjerë), së bashku me elemente të tjera të vlerësimit të figurës dhe aftësive profesionale, në varësi të shqyrtimit të tyre.*

1.3 Komisioneri Publik, në ankimin e datës 12.7.2023, në pikën 14.29 të tij, si dhe 2.6 të parashtrimeve të datës 10.1.2024, ashtu sikurse dhe vëzhguesi ndërkombëtar, ndër të tjera, ka arsyetuar se *proporcionaliteti vlerësohet rast pas rasti, duke pasur parasysh disa aspekte në drejtim të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklarimeve me provat e tjera dhe çdo të dhënë apo informacion të administruar në fashikull gjatë hetimit administrativ në Komision apo atij në Kolegj.*

1.4 Negativiteti i konstatuar në rastin konkret lidhet me një pasuri të vetme në momentin e blerjes së saj dhe nuk shtrihet në vite dhe, si i tillë, ka nevojë t'i nënshtrohet juridiksionit rivlerësues të Kolegjit, në drejtim të përcaktimit të saktë të nivelit të ligjshmërisë së burimeve të subjektit të rivlerësimit dhe pasojën që sjell në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë.

2. (B) Për sa i përket shpenzimeve të jetesës

2.1 Vëzhguesi Ndërkombëtar referon se lidhur me llogaritjet e shpenzimeve të jetesës (*masës së shprehur në përqindje*) për periudhën përpara vitit 2000, Kolegji ka pasur qasje të ndryshme, në varësi të veçantive të subjekteve të rivlerësimit, megjithëse referenca e INSTAT-it ka qenë gjithmonë vendimtare, aty ku disponohej një e tillë.

2.2 Komisioneri Publik, në ankimin e datës 12.7.2023, në pikën 14.28 të tij dhe 2.5 të parashtrimeve të datës 10.1.2024, ndër të tjera, ka arsyetuar se, *në gjendjen që janë aktet në dosje, është i nevojshëm rivlerësimi nga Kolegji i zërave të analizës financiare, pjesë përbërëse e së cilës janë dhe shpenzimet e jetesës për periudhën e analizuar, në drejtim të përcaktimit të saktë të burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur/tjerë të lidhur dhe pasojën që sjell në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, si një praktikë e përdorur tashmë për analizimin e mundësive financiare të subjekteve gjatë jurisprudencës së Kolegjit.*

3. (C) Mbi nivelin e provueshmërisë së deklarimeve dhe deklaratave të paraqitura gjatë procesit të rivlerësimit

3.1 Vëzhguesi Ndërkombëtar ka rivendosur në vëmendje ekzistencën e standardit ligjor të pranuar dhe nga Kolegji, në vendimin e tij (JR) nr. 45/2022, për subjektin e rivlerësimit ***, ***, në paragrafin 75 të tij, mbi vlerën e kufizuar provuese të deklaratave të paraqitura gjatë procesit të rivlerësimit dhe faktit se vlera provuese e tyre vlerësohet nga trupi gjykues, rast pas rasti, *në drejtim të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklarimeve me provat e tjera të administruara në fashikull gjatë hetimit administrativ në Komision dhe atij në Kolegj.*

3.2 Komisioneri Publik ka ushtruar të drejtën e ankimit, ndër të tjera, nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, pasi dhe, në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së, ka vlerësuar se vendimi i Komisionit *nuk është në pajtueshmëri të plotë me gjendjen*

e fakteve dhe provave të administruara në fashikull, për krijimin e bindjes së subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë së tij, në kuptim të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016².

3.3 Komisioneri Publik vlerëson se adresimi i kësaj pike, i referohet Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i cili shqyrton çështjet dhe vendos standardet bazuar në parimet e procesit të rregullt ligjor, parimin e kontradiktoritetit, parimin e ligjshmërisë, parimin e sigurisë juridike dhe parimin e barazisë para ligjit.

4. D) Lidhur me përmbajtjen Mendimit - (A) për vlerësimin e pasurisë

4.1 Komisioneri Publik, në drejtim dhe të detyrave të lëna nga Kolegji, vlerëson se vëzhguesi ndërkombëtar, në këtë pikë të Mendimit, ka saktësuar qartë situatën faktike konkrete, duke mbështetur përfundimin e çmimit të blerjes së apartamentit në shumën prej 36.000 dollarë, si dhe ka vlerësuar se kjo situatë është parashtruar saktë në ankimin e Komisionerit Publik, duke adresuar dhe paragrafët respektivë.

5. (B) Për vlerësimin e aftësive profesionale

5.1 Vëzhguesi Ndërkombëtar referon se vlerësimi i aftësisë profesionale është i lidhur ngushtë me masën e ankimit, pasi ai do të duhet të përcaktohet nga Kolegji në lidhje me përmbajtjen e ankimit të Komisionerit Publik. Në vlerësimin e vëzhguesit ndërkombëtar, Komisioneri Publik ka paraqitur ankimin kundër vendimit të Komisionit, bazuar në Rekomandimin e ONM-së dhe në thelb ka pranuar shqetësimet e ONM-së në ankimin në fjalë, **duke përfshirë të gjitha çështjet e tjera të nevojshme...** duke përfunduar se është vendimtare analiza e çështjes që lidhet me pushimin e hetimeve në vitin 2016, ku ishte përfshirë *** *** (në lidhje me të cilën Komisioni nuk konstatoi asnjë problem) dhe ku duket se ka mangësi profesionale.

5.2 Komisioneri Publik, ashtu sikurse ka parashtruar në shkaqet e ankimit, vendos në vëmendje të Kolegjit se kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, është i detyruar që ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret.

5.3 Në këto rrethana, Komisioneri Publik, referuar gjendjes së akteve në dosje të Komisionit, në pikën 14.8 të ankimit, datë 12.7.2023, ka parashtruar para Kolegjit se, nga shqyrtimi i akteve, Komisionit i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e hetimeve në ngarkim të shtetasit ***. ***. dhe dërgimin e çështjes penale në gjykim për veprën penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, në ngarkim të shtetasit ***. ***. Po ashtu, në analizë të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit, është parashtruar se procedimi penal, nr. ****/2015, është pjesë e Raportit të vlerësimit të aftësive profesionale, hartuar nga KLP-ja me nr. *** prot., datë **.4.2022, ku ky procedim penal është trajtuar si një nga pesë dosjet e përzgjedhura me short, konkretisht dosja nr. 4, e tij, duke referuar se nga aktet nuk duket se Komisioni ka konstatuar problematika në analizimin e këtij procedimi.

² Referuar prg. të parë të Kërkit të ankimit.

5.4 Komisioneri Publik, në ankimin e datës 12.7.2023, në pikën 14.10.1 të tij, si dhe në parashtrimet në seancën e datës 10.1.2024, në pikën 1.8.1, ka theksuar se, në gjendjen që janë aktet në dosje, përgjigjet e subjektit në pyetësorin e datës 31.10.2022, si dhe vërtetimi nr. ***, datë **.11.2022, bashkëlidhur këtij pyetësori, i lëshuar me kërkesë të subjektit nga shoqëria “**** **” sh.p.k., nënshkruar nga administratori ***, ***, për të cilin duket se subjekti në procedimin penal nr. ***/2015 ka pushuar hetimet në ngarkim të tij, nuk duket se janë akte që krijojnë bindjen për të arritur në nivelin e provueshmërisë, lidhur me vlerën e saktë të blerjes së kësaj pasurie.

5.5 Këto rrethana, Komisioneri Publik i ka trajtuar në pikën 14.15 të ankimit dhe 1.14 të parashtrimeve të datës 10.1.2024, si rrethana të cilat duhen duhen rivlerësuar nga Kolegji në drejtim të arritjes së konkluzionit mbi saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, duke pasur parasysh kompetencat e Kolegjit, si organi që kontrollon vendimmarrjen e Komisionit.

5.6 Në përfundim, Komisioneri Publik vlerëson se kjo pikë e *Gjetje dhe Mendim* të vëzhguesit ndërkombëtar, në zbatim të nenit B, pikës 3, germa “b”, të aneksit Kushtetues dhe nenit 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, duhet konsideruar provë në këtë proces dhe vlerësuar si e tillë nga Kolegji.

5.7 Komisioneri Publik vlerëson se rezultatet mbi procedimin penal nr. ***/2015 shërbejnë në drejtim të shkaqeve të ankimit, si çështje tjetër e nevojshme, për verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklaramit të subjektit të rivlerësimit në raport me vërtetimet e nënshkuara nga shtetasi ***, ***, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “****. **” sh.p.k., në kushtet e përjashtimit të çdo rrethane favorizuese mes palëve.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO